

Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Projekti "Së bashku Kundër Abuzimit të Fëmijës", financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës - KEC dhe Qendra për Studime të Avancuara – FIT . Ky projekt ka për synim të sigurojë që të gjithë fëmijët të trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin dhe të drejtat e tyre duke promovuar mjedise pa abuzim në shkollat e Kosovës.

Ideja e zhvillimit të këtij kursi ka nisur në kuadër të implementimit të projektit "Së bashku kundër abuzimit të fëmijës" me qëllim që të mbrohen të drejtat e fëmijës duke promovuar mjedisin pa abuzim në shkollat e Kosovës.

Bota kibernetike domosdoshmërisht të shpie drejt mundësive të reja dhe përfitimeve shumë dimensionale, si: fleksibilitetin, përforcim të vazhdueshëm të aftësive intelektuale dhe shfrytëzimin e kohës në mënyrë racionale.

Mundësitë e të mësuarit në internet ofrojnë mjete specifike për të marrë certifikata, e cila është një mënyrë e përshtatshme për mësime të mësimdhënësit për të përmbushur kërkesat e zhvillimit profesional për licencim - 100 orë krediti në 5 vjet.

Në kuadër të projektit, 46 mësime të mësimdhënës kanë ndjekur kursin në fazën pilotuese të këtij programi të trajnimit. Gjatë kohëzgjatjes së projektit "Së bashku kundër abuzimit të fëmijëve" kursi do t'u ofrohet 2000 mësime të mësimdhënësve nga shkollat partnere të projektit në tri komuna: Vushtrri, Ferizaj dhe Kamenicë. Më pas, ky kurs apo program i trajnimit do të ofrohet për të gjithë mësime të mësimdhënësit e shkollave në Kosovë.

Qëllimet e programit:

Qëllimi i këtij kursi është që t'i pajisë mësime të mësimdhënësit me njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për të ofruar një mjedis miqësor dhe të sigurt për fëmijët në shkollë, përmes parandalimit dhe raportimit/referimit të rasteve të abuzimit të fëmijëve. Me përfundimin e kursit, mësime të mësimdhënësit do të mund të veprojnë si agjentë të ndryshimit për të pasur shkolla pa abuzim të fëmijëve.

Pjesëmarrësit në këtë kurs do të aftësohen që të:

- Përshkruajnë konceptet e mirëqenies së fëmijës dhe mjedisit miqësor për fëmijët;
- Përkufizojnë abuzimin, karakteristikat e tij dhe kategoritë dalluese;
- Identifikojnë instrumentet ligjore për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi dhe raportimin e tyre brenda një kornize të përbashkët;
- Përshkruajnë manifestimin e llojeve të ndryshme të abuzimit;
- Identifikojnë shenjat e abuzimeve dhe arsyetojnë dyshimet për ekzistencën e tyre;
- Kuptojnë pasojat afatgjata të abuzimit dhe vlerësojnë rrezikun e tyre;

- Kuptojnë rëndësinë e organizimit të hapësirave shkollore në harmoni me standardet e sigurisë;
- Reflektojnë për përgjegjësinë e tyre dhe gjithë stafit të shkollës për sjellje në përputhje me politikat dhe standardet e operimit;
- Kuptojnë përgjegjësinë e tyre shoqërore e institucionale në raportimin e rasteve;
- Demonstrjnë vetëbesim e shkathtësi për reagim ndaj abuzimit.

Përmbajtja:

Përmbajtja e kursit përqendrohet në të kuptuarit se çfarë është abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve; mbështetja e mësimeve për të kuptuar përgjegjësitë për identifikimin e hershëm të abuzimit të fëmijëve (Sistemi i paralajmërimit të hershëm); të kuptuarit e rolit të komunitetit shkollor për të parandaluar dhe raportuar abuzimin e fëmijëve; elaborimi i temës së parandalimit të abuzimit të fëmijëve dhe pasojave përmes aktiviteteve ekstra kurrikulare.

Ky kurs përbëhet nga tri module të ndërlidhura në mes vete, të cilat pjesëmarrësve i ofrojnë njohuri përmes përmbajtjeve informative, si dhe shkathtësi përmes pyetjeve reflektive e rasteve të studimit.

Në modulën e parë trajtohet në përgjithësi përkufizimi, karakteristikat dhe kategoritë e abuzimit të fëmijëve, në dritën e koncepteve udhëheqëse të të drejtave të fëmijëve, si mirëqenia e fëmijëve dhe mjedisi miqësor për fëmijët. Ky modul, po ashtu, trajton kornizën normative për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi.

Moduli i dytë trajton manifestimin e kategorive të ndryshme të abuzimit (abuzimit fizik, abuzimit emocional, abuzimit seksual dhe neglizhimit), si dhe pasojat afatgjata të abuzimit të fëmijëve (pasojat e shëndetit fizik, pasojat psikologjike, pasojat e sjelljes dhe ato shoqërore).

Moduli i tretë ofron informata praktike për krijimin e mjedisit miqësor dhe të sigurt për fëmijë nëpër shkollë, përfshirë organizimin e ndërtesave shkollore, politikat dhe procedurat standarde të operimit, si dhe procedurat e raportimit dhe referimit të rasteve të abuzimit të fëmijëve.

Në fund të secilit modul pjesëmarrësi i kursit do të reflektojë mbi përmbajtjen e modulit duke u përgjigjur në pyetjet që lidhen me përmbajtjen, e që janë të lidhura me situata jetësore reale në shkollë e komunitet.

Grupi i synuar

Kursi i dedikohet të gjithë mësimeve të arsimit parauniversitar.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Ky kurs/program trajnimi do të organizohet në formën on-line. Në vitet e fundit, teknologjia ka ofruar mundësinë për të përfituar nga të mësuarit përmes internetit. Zhvillimi i kurseve përmes platformës on-line për parandalimin e abuzimit dhe reagimin ndaj abuzimit është një risi për Kosovën, prandaj si i tillë do të ketë një efekt të fortë motivues për të gjithë përdoruesit.

Me qëllim të zhvillimit të metodave efektive dhe angazhuese pedagogjike mbi parandalimin dhe reagimin ndaj abuzimit, mësimeve në Kosovë duhet ta shohin këtë formë mësimi si një inovacion që mund të mbështesë dhe inkurajojë zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional. Pjesëmarrësi regjistrohet për vijimin e kursit përmes platformës <https://kec-elearning.org/>

Pjesëmarrësi e ndjek tempon individuale të të nxënit duke naviguar përmes kursit i cili është i disenjuar ashtu që ka mundësi të kthimit pas e kapërcimit përpara në përmbajtje të kursit, duke përfshirë edhe mundësitë e shumëfishta për vlerësim të informatave të fituara gjatë kursit. Pjesë të përmbajtjes së kursit mbështeten me burime elektronike që mundësojnë lexim më të thelluar për ato përmbajtje, si dhe video-prezantime që përkrahin të nxënit.

Kursi mund të ndiqet nga pjesëmarrësi njëherësh (pa ndërprerje) ose në sesione të disahershme (me ndalesa), duke iu përshtatur kohës në dispozicion të pjesëmarrësit. Vlerësohet se kursi mund të përmbushet për 8 orë efektive.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij kursi pjesëmarrësit do të certifikohen duke u kredituar me gjithsejt 8 orë trajnimi.

Kriteret për certifikim janë:

- Përshkimi i gjithë përmbajtjes së kursit (të gjitha temave të të trija moduleve)
- Suksesi së paku 80% në reflektimet përgjatë kursit;

Plotësimi i kriterëve të certifikimit vërtetohet përmes një sistemi përcjellës në platformën e kurseve online dhe lidhet me gjenerimin e certifikatës elektronike. Certifikata elektronike shndërrohet në certifikatë të shtypur e të nënshkruar nga përfaqësuesit e organizatës implementuese dhe MASHT.

Materialet e trajnimit

- Materiali bazë për kursin on-line për mësimdhënës “Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi”
- Kursi online për mësimdhënës “Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi”, në dispozicion në <https://kec-elearning.org/>.